



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



PSH .nr.217/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: NSH “MVR Elektromontues” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE N.N.P “Toni”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra me nr. të prokurimit 644-19-7674-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Komuna e Vushtrrisë më datën: 17.04.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: NSH “MVR Elektromontues” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra, me nr. të prokurimit 644-19-7674-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Komuna e Vushtrrisë.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra” me nr. të prokurimit 644-19-7674-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Vushtrrisë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomike ankues NSH “MVR Elektromontues” - Prishtinë, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik NSH “MVR Elektromontues” - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 30.03.2020 me nr. 217/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik në qytet dhe fshatra” me nr. të prokurimit 644-19-7674-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Komuna e Vushtrrisë. duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7,52,59,60,61 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe
- AK ka shkelur Rregulloren B57 lidhur me trajtimin e çmimeve jo-normalisht të ulëta.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 01.04.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 06.04.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.SH “MVR Elektromontues” se AK edhe gjatë fazës së rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se në shumë pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta dhe në të njëjtën kohë duke favorizuar ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE N.N.P “Toni”, e cila ka ofruar çmime spekulative/ manipuluese, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka një vendim të OSHP-së, PSH.nr.34-37/20 të datës 26.02.2020 me të cilin është rekomanduar që aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK gjatë fazës së rivlerësimit pothuaj ka përsëritur raportin e vlerësimit të fazës së parë duke mos e interpretuar në mënyrë korrekte vendimin e OSHP-së, PSH.nr 34-37/20 të datës 26.02.2020.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues se oferta e tyre është shpallur e papërgjegjshme me arsyetimin se në shumë pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulët, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin OSHP-së, PSH.nr 34-37/20, ku po citoj një pjesë të vendimit që lidhet me këtë pretendim “Paneli shqyrtues sqaron se për këtë pikë pretenduese kemi vendimin e OSHP-së, PSH.nr.590/19 të datës 13.11.2019 i cili ndër të tjera sqaron se kur kemi kriterin çmimi më i lirë i poentuar duhet të eliminohet nga praktika kur çmimin e një ofertuesi e krahason me çmimin e një ofertuesi tjetër, pasi që kriteri i tillë kërkon që çmimet e poentuar të bazohen në çmimet e ofruara, e jo duke u bazuar në çmimet e ofertuesve të tjerë sepse në rast se kemi të bëjmë me krahasimin e çmimeve të ofertave të ndryshme me njëra tjetrën atëherë kemi të bëjmë me kriterin çmimi më i ulët dhe gjen zbatim rregullorja për tenderët jo normalisht të ulët. Paneli shqyrtues sqaron se Neni 52.6 i LPP-së përcakton: Në rast të kontratave për shërbime të shumëfishta ose edhe në rast të kontratave për çmime për njësi, çmimet mund të peshohen në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në rast të çmimit më të ulët, duke peshuar çmimet “çmimet e peshuara bazohen në çmimin e ofruar nga Operatorët Ekonomik individual, prandaj nuk lejohet që të përcaktohen pikët duke krahasuar çmimet e ofertuesve të ndryshëm”. Paneli shqyrtues sqaron se në rastin e kriterit çmimi më i lirë i poentuar gjithashtu minimizohet mundësia e manipulimit me çmime pasi që sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë. P.sh. nëse pesha është dhënë kategorive të artikujve apo shërbimeve duke u bazuar në raportet sasiore/rëndësinë e kategorisë ndërmjet tyre, atëherë edhe shpenzimet për kategori duhet të ruajnë të njëjtin raport. Përfundimisht, AK (njësia implementuese e kontratës) mbetet përgjegjëse që në secilin rast të dëshmoj në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të AK-së, kjo në bazë të interpretimit të KRPP-së të datës 10.12.2019 tek pyetjet e shpeshta, pyetja nr.68.

Bazuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.34-37/20 të datës 26.02.2020, konsideroj që Autoriteti Kontraktues nuk e ka zbatuar drejt vendimin e OSHP-së, dhe pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me date: 10.04.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, nuk e ka njoftuar OSHP-në se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 17.04.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.SH “MVR Elektromontues” se AK edhe gjatë fazës së rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se në shumë pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta dhe në të njëjtën kohë duke favorizuar ka rekomanduar për kontratë ofertën e OE N.N.P “Toni”, e cila ka ofruar çmime spekulative/manipuluese. Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë, ku i njëjti e ka bindur autoritetin kontraktues lidhur me çmimet e ofruara. Për më tepër, AK bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që të bëjë rritjen e sigurimit të ekzekutimit në rast se rekomandohet nga 10% në 25%, ku ky OE ka pranuar që ta rris në 25% sigurinë e ekzekutimit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.SH “MVR Elektromontues” se oferta e tyre është shpallur e papërgjegjshme me arsyetimin se në shumë pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta, Paneli Shqyrtues sqaron se oferta e dorëzuar e OE ankues N.SH “MVR Elektromontues” në shumë pozicione ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta (shumë pozicione janë me çmim 0.10 €) dhe në disa pozicione edhe çmime jo-normalisht të larta në krahasim me çmimet e tregut. AK ka kërkuar informata mbi tenderin jo-normalisht të ulët duke kërkuar informata për një numër të madh të pozicioneve të listuara në tabelë lidhur me çmimet e ofruara nga ky OE. Kurse, OE ankues N.SH “MVR Elektromontues” përmes përgjigjes për pozicionet e kërkuara konfirmon se qëndron prapa çmimeve të ofruara duke ofruar një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë “Elektring” Shpk - Ferizaj e cila deklaron se N.SH “MVR Elektromontues” ka ofertuar me çmimet bazuar në ofertën paraprake të bërë nga kompania “Elektring” Shpk.

Paneli Shqyrtues sqaron se çmimet e ofruara nga OE ankues janë çmime jo-normalisht të ulëta sepse është e pamundur që të bëhet ekzekutimi i punëve me çmime të tilla. Çmimet jo-normalisht të ulëta janë dhënë sikurse në pozicionin 10 i kategorisë A “Porosia dhe montimi i relese IC ASTRO Shneider, Siemens, ABB ose e ngjashme ekuivalent” me çmimin e ofruar 0.10€ (10 cent), ndërsa nga analiza e para masës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej 110.00 €, pastaj pozicioni 4 i kategorisë B “Furnizimi dhe montimi I trupit ndriçues REMO 400 me gjashtë poça GX 53 për montim në shesh te njëjta me ato

ekzistuese” që nga OE ankues N.SH “MVR Elektromontues” është ofruar me çmim prej 0.10 € (10 cent), ndërsa nga analiza e para masës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej 190.00 €, më tej, pozicioni 9 i kategorisë B “Furnizimi dhe montimi i shtyllës së betonit 9m, sipas porosisë së organit mbikëqyrës” që nga OE ankues N.SH “MVR Elektromontues” është ofruar me çmim prej 1.00 €, ndërsa nga analiza e para masës nga AK ky pozicion është parashikuar me çmim prej 90.00€. Pretendimet për pozicione paneli shqyrtues ka dhënë përgjigje në vendimin paraprak për këtë aktivitet të prokurimit i cili aktivitet me vendimin e mëparshëm është kthyer në rivlerësim vetëm për tu vërtetuar certifikatat e OE të rekomanduar për kontratë.

Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit dhe në bazë të shkresave të lëndës sqaron se autoriteti kontraktues ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave konform nenit 59 të LPP-së. Për më tepër, AK ka pasur në konsideratë edhe nenin 60 të LPP-së për shkak se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka pasur ofertën me çmimin më të lirë. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues



Blerim DINA

Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK Autoritetit Kontraktues –Komunës së Vushtrrisë

1x1 OE NSH”MVR Elektromontues”-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.